

# Manuali i përdorimit

## Detektori i tymit RM 680110



## I. Pasqyra e sinjaleve paralajmëruese dhe të funksionimit

<p>))) Ton i lartë sinjalizues çdo 2 sekonda</p> <p>✱ LED pulson 1 herë në çdo 2 sekonda</p>		Alarm
<p>))) Ton i ulët sinjalizues 3 herë në çdo 5 minuta</p> <p>✱ LED pulson 1 herë në çdo 5 sekonda</p>		Defekti i pajisjes
<p>))) Ton i ulët sinjalizues 2 herë në çdo 10 minuta</p> <p>✱ LED pulson 2 herë në çdo 30 sekonda</p>		Kontroll i distancës
<p>))) Ton i ulët sinjalizues 3 herë në çdo 15 minuta</p> <p>✱ LED pulson 3 herë në çdo 15 minuta</p>		Identifikim i çmontimit
<p>))) Ton testues (volum i ulur)</p> <p>✱ LED pulson njëkohësisht me tonin testues</p>		Testim i funksionit
<p>✱ Asnjë sinjal akustik</p> <p>✱ LED nuk pulson</p>		OK Funksionim normal

## II. Shpjegimet



### Alarm

Për këtë vini re paragrafin V. - Sjellja në rast zjarri (shih faqen mbrapa). Në rast alarmi, detektorii tymit RM 680110 le të pushohet duke shtypur butonin e testimit. LED pulson akoma në çdo dy sekonda. Nëse shkaku nuk korrigohet për 15 minuta, alarmi fillon nga e para.

### Sjellja në rast alarmi të rremë

Pluhuri, uji ose avujt e kuzhinës mund të shkaktojnë alarm të rremë (ton i lartë sinjalizues). Alarmi i rremë pushohet duke shtypur butonin e testimit. Kujdesuni menjëherë për ajrimin e mirë të dhomës.

Nëse toni sinjalizues vazhdon të bjerë, aktivizoni butonin e testimit. Informoni paraprakisht komshinjtë, në mënyrë që zjarrfikësja të mos njoftohet pa arsye.

### Sjellja në rast alarmi të gabuar

Alarmi i gabuar (ton i lartë sinjalizues pa ndonjë arsye që njihet) pushohet duke shtypur butonin e testimit. Informoni paraprakisht komshinjtë, në mënyrë që zjarrfikësja të mos njoftohet pa arsye.



### Defekti i pajisjes

Në rast të ndonjë defekti të pajisjes, detektorii i tymit RM 680110 heshtet duke shtypur butonin e testimit. Bie një sinjal i shkurtër, LED pulson sërish. Aktivizimi i heshtjes së sinjalizimit për defekt zgjat tre ditë.

Pasi heshtja e sinjalizimit aktivizohet tre herë çaktivizimi mundësohet vetëm për një ditë.

Kur heshtja e sinjalizimit është aktive, LED vazhdon të pulsojë 1 herë në çdo pesë sekonda.

Jeni të lutur të ndërroni pajisjen. Për këtë qëllim, kontaktoni me administratorin/ qiradhënësin tuaj.



### Kontroll i distancës

Në rast alarmi për shkak të kontrollit të distancës, heshtni detektorin e tymit RM 680110 duke shtypur butonin e testimit. Bie një sinjal i shkurtër, LED pulson sërish. Aktivizimi i heshtjes së kontrollit të distancës zgjat 3 ditë.

Largoni të gjitha orenditë dhe pengesat në distancën 50 cm nga detektorii i tymit. Kur heshtja e sinjalizimit është aktive, LED vazhdon të pulsojë 2 herë në çdo 30 sekonda.

Nëse detektorii i tymit RM 680110 duhet zhvendosur, informoni administratorin/qiradhënësin tuaj, për të garantuar sërish një montim profesional.



### Identifikim i çmontimit

Detektorii i tymit RM 680110 nuk duhet çmontuar - përveç rasteve kur bëni rinovime.

Sinjalizimi akustik i detektorit të tymit nuk heshtet, për këtë shihni pjesën III. Udhëzimet për sigurinë.



### Testim i funksionit

Me shtypjen e butonit të testimit detektorii i tymit RM 680110 kryen një testim të funksionit të tij.

Vini re që më pas pajisja heshtet për 15 minuta. Në këtë moment nuk ka më alarm akustik.



### Funksionim normal

Kur funksionon normalisht, detektorii i tymit RM 680110 nuk jep asnjë sinjal akustik dhe LED nuk pulson.



### III. Udhëzimet për sigurinë

#### Veprimet gjatë rinovimeve

- Detektori i tymit RM 680110 **nuk duhet çmontuar** – përveç rasteve kur bëni rinovime.
- Gjatë rinovimit të shtëpisë hiqeni pajisjen, futeni në një qese plastike dhe ruani detektorin dhe bazamentin më vete në një ambient pa pluhur.
  - Mos e lyeni me bojë, mos e vishni me letër ose me ngjitime detektorin e tymit RM 680110.
  - Për ta shkëputur pajisjen nga bazamenti, rrotulloni kutinë në kahun e kundërt të akrepave të orës dhe hiqeni.
  - Nëse detektori i tymit RM 680110 qëndron i çmontuar për 2 javë, ai lëshon një sinjal akustik (shih tabelën "I. Pasqyra e sinjaleve paralajmëruese dhe të funksionimit - Identifikimi i çmontimit"). Sinjali fiket kur pajisja rrotullohet përsëri në bazament. Në gjendje të çmontuar pajisja nuk mund të heshtet.
- Pas rinovimit montoni menjëherë **të njëjtën pajisje në të njëjtin vend** dhe provoni funksionimin e saj duke shtypur butonin e testimit. Gatishmëria e funksionimit aktivizohet duke e rrotulluar detektorin e tymit RM 680110 në bazament.

#### Ruajtja e distancave

- Orenditë si p.sh. dollapët, perdet, baldakinat ose llambat nuk duhen vendosur **më afër se 50 cm** nga detektori i tymit RM 680110.

#### Informoni menjëherë administratorin/ qiradhënësin tuaj në rastet e mëposhtme:

- Gjatë ndryshimeve strukturore dhe të përdorimit të hapësirave të veçanta.
- Nëse p.sh. brenda dhomës së gjumit bëhet një ndarje ose ndërtohet një mur ndarës ose nëse dhoma ekzistuese e ndenjjes kthehet në dhomë gjumi ose në dhomë për fëmijët, pasi për këto nevojiten detektorë tymi shtesë RM 680110.

#### Udhëzim për përdorimin e ventilatorëve

Ventilatorët ndikojnë negativisht në qarkullimin e tymit të detektorit të tymit RM 680110 dhe vonojnë zbulimin e tymit.

#### Bateria e integruar

Mos e hapni detektorin e tymit RM 680110. Bateria është e integruar dhe nuk ka nevojë të ndërrohet.

#### Montimi vetëm nga specialistë të certifikuar

Montimi kryhet vetëm nga specialistët e autorizuar. Ata e montojnë detektorin e tymit RM 680110 me materialin përkatës të montimit (me dy upa dhe vida për secilin) në dy vrimat e montimit sipas DIN 14676.

### Funksionet

- 1 Sensorët me ultratinguj për kontrollin e distancës
- 2 Vrima e hyrjes së tymit
- 3 Butoni i testimit
- 4 LED i kuq për sinjalizim optik
- 5 Altoparlanti për sinjalizim akustik
- 6 Dioda infra e kuqe për montim



### IV. Të dhënat teknike

- Detektori i tymit RM 680110 është prodhuar sipas standardit DIN EN 14604 dhe dallohet nga etiketa "Q". Kusht për këtë është testimi i suksesshëm sipas kërkesave të rrepta të udhëzuesit 14-01 të VFDB<sup>1</sup>.
- Identifikimi i tymit sipas metodës me përhapjen e ndriçimit.
- Bateria e integruar e fiksuar me dhjetë vjet jetëgjatësi plus një vit rezervë.
- Monitorim me rreze infra të kuqe i vrimës së hyrjes së tymit.
- Kontroll automatik i distancës - testim me ultratinguj, nëse në rrezen prej 50 cm gjenden pengesa, të cilat mund të vonojnë depërtimin e tymit.
- Kontroll automatik i rregullt për funksionimin; kontrolli shtesë për funksionimin mundësohet në çdo moment në mënyrë manuale përmes butonit të testimit.
- Identifikim i papastërtive dhe ndjekje e ndjeshmërisë.
- Identifikim i çmontimit pas heqjes së detektorit nga bazamenti.
- Të gjitha njoftimet gjatë natës – përveç alarmit për tym zjarri – shtyhen për ditën në vijim.

Ndoshta detektori i tymit RM 680110 nuk është i përshtatshëm për personat me aftësi perceptuese të kufizuara. Në këtë rast jeni të lutur t'i drejtoheni administratorit/ qiradhënësit tuaj.

<sup>1</sup>VFDB: Shoqata për Mbështetjen e Mbrojtjes nga Zjarri në Gjermani.

## V. Sjellja në rast zjarri

### A) Zjarr në shtëpi



### B) Zjarr në kafazin e shkallëve



1772 0682  
Atral Secal GmbH  
Schlangenbader Straße 40,  
D-65344 Eltville, Evropë  
1772-Q-130592

EN 14604:2005  
Detektori i tymit RM 680110  
Nr. i deklaratës së performancës: 1772-130592  
Qëllimi i përdorimit: Sistemi 1 për mbrojtjen nga zjarri

Kjo pajisje përputhet me kërkesat themelore  
dhe me dispozitat e tjera përkatëse të Direktivës  
1999/5/BE (RT&T).

Kërkesat RoHS përmbushen.

